



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E BUJQËSISË, PYJEVE, KULLOTAVE DHE I UJITJES

Nr. 1302 / Prot.

92

Himarë, më 30.04 2026

NJOFTIM PUBLIK

PËR KONSTATIMIN DHE EVIDENTIMIN NË TERREN

të pasurive private që preken nga realizimi i projektit për interes publik me objekt:

“Ndërtim dhe rikualifikim i rrugës paralele me rrugën e plazhit, Borsh”

TË GJITHË PRONARËT BANORËT/SUBJEKTET E PREKURA

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në mbështetje të nenit 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, VKM nr. 138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe shpërblimit të pronës private për interes publik”, i ndryshuar, në kuadër të zbatimit të projektit me objekt :

“Ndërtim dhe rikualifikim i rrugës paralele me rrugën e plazhit, Borsh”, investim i financuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, njoftohen të gjithë pronarët/subjektet që rezultojnë të prekur nga gjurma e projektit se Bashkia Himarë do të kryejë procedurat për **konstatimin dhe evidentimin në terren** të pasurive private, sipas dokumentacionit teknik dhe planvendosjes së miratuar.

Ju njoftojmë se nga ana e Bashkisë Himarë do të kryhen procedurat administrative për **konstatimin dhe evidentimin në terren** të pasurive private që rezultojnë të prekur nga gjurma e projektit, sipas dokumentacionit teknik dhe planvendosjes së miratuar.

Ftojme të gjithë banorët/subjektet e prekur nga zbatimi i projektit me objekt : **“Ndërtim dhe rikualifikim i rrugës paralele me rrugën e plazhit, Borsh”**, se procesi i **konstatimit dhe evidentimit në terren** do të zhvillohet sipas kalendarit të mëposhtëm :

Data : 04.05.2026 - 15.05.2026

Ora : 10:00 - 13:00

Vendi : Fshati Borsh, Njësia Administrative Lukovë, Himarë.

Procesi i verifikimit do të përfshijë:

- Identifikimin e kulturave të evidentuara në pjesën e prekur;
- Identifikimin e dhe matjen në terren të pasurisë
- Verifikimin e të dhënave kadastrale;
- Evidentimin e objekteve, ndërtimeve, dhe elementeve të tjera ekzistuese brenda gjurmës së projektit.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, banorët/subjektet e prekura kanë të drejtë:

- Të informohen mbi përmbajtjen e projektit dhe ndikimin mbi pasurinë e tyre;
- Të paraqesin dokumentacionin përkatës të pronësisë;
- Të paraqesin pretendime, kundërshtime ose sqarime gjatë fazës së verifikimit në terren.

Banorët/Subjektet e njoftuara duhet të jenë të pranishme në momentin e kryerjes së verifikimit në terren, sipas grafikut që do t'u komunikohet individualisht nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Himarë.

Për çdo sqarim të mëtejshëm, mund të paraqiteni pranë Bashkisë Himarë gjatë orarit zyrtar ose duke ju drejtuar adresës zyrtare të Bashkisë Himarë : info@himara.gov.al

- *Bashkëlidhur lista e emrave të pasurive të prekura.*

Jeni të lutur të merrni pjesë, pasi pjesëmarrja juaj është e rëndësishme për konstatimin dhe evidentimin në terren.

KRYETARI I BASHKISË
Vangjel Tavo

ME DELEGIM DHE ME
URDHËR
ZËVENDËSKRYETARI
Erifili Berberi



Konceptoi : K.Bala (Specialist)
Miratoi : A.Panajoti (Drejtor)



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA HIMARË

LISTA EMËRORE E PERSONAVE DHE PASURIVE TË PREKURA

Nr.	Emër mbiemër	Nr.Pasurie	Adresa
1.	Salihe Avdi Kodhima; Mirel Valter Kodhima; Erlina Valter Kodhima, Luis Valter Kodhima (<i>Bashkëpronësi</i>)	117/7	Borsh
2.	Lani Yzeir Dervishaj	125/8	Borsh
3.	Xhevair Selman Dedi	117/16	Borsh
4.	Cano Ilias Hysi; Julian Cano Hysi; Arjanit Cano Hysi; Alban Cano Hysi; Dritan Cano Hysi (<i>Bashkëpronësi</i>)	170/38	Borsh
5.	Ramadan Mahmud Lala	170/39	Borsh
6.	Ramadan Omal Këllëçi.	170/42	Borsh
7.	Rushit Qemal Këllëçi.	170/41	Borsh
8.	Erjon Muho Kodhima; Ermal Muho Kodhima; Perjana Mihal Kodhima; Sofia Nevzat Kodhima. (<i>Bashkëpronësi</i>)	117/14	Borsh